



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E MËTUTJESHËM TË SISTEMIT TË CILËSISË PËR VLERËSIM TË JASHTËM TË AAP NË KOSOVË

PRISHTINË, 2011



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EU KOSVET V

Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimi dhe Zhvillimi i AKK & KKK

Nr. i Kontratës. 2009/216-809

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Komisionit Evropian.
Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e kontraktuesit, PEM GmbH, dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Komisionit Evropian.

PËRMBAJTJA

1.Hyrje	6
Qëllimi i Udhëzuesit	6
Audienca e piketuar	6
2.Menaxhimi i Cilësisë në Arsim dhe Aftësim	7
Pasqyrë e shkurtër e zhvillimeve	7
Sigurimi dhe inspektimi i cilësisë	8
3.Sistemi ekzistues i cilësisë për AAP në Kosovë	9
Komponentët e Sistemit të Cilësisë në Kosovë	9
Situata në Kosovë në lidhje me sigurimit të cilësisë të jashtëm të AAP-së	10
4.Çështjet dhe Mangësitë	12
Çështjet në sigurimin e cilësisë së jashtme në Kosovë	12
Mangësitë në sigurimin e cilësisë së jashtme në Kosovë	12
5.Propozimet për hapat në të ardhmen	13
6.Propozimet për bashkëpunim në të ardhmë	18
7.Konkluzione	18
Anekset	21
Aneksi 1: Analiza e Ligjit të AAP me referencë në rolin e KAAP në lidhje me Vlerësimin e jashtëm/sigurimi i cilësisë në AAP	21
Aneksi 2: Si mundet që inspekcioni të promovoj përmirësimet?	22

1. HYRJE

EU KOSVET V ka ofruar asistencë teknike për të mbështetur zhvillimin në veçanti të Autoritetit Kualifikues Kombëtar (AKK), por gjithashtu aspektet tjera të sigurimit të cilësisë në AAP, në kuadër të punës është bërë e qartë se aspektet e caktuara të sistemit zhvillohen për të përmbushur standardet e BE-së, aspektet e tjera nuk lidhen më mënyrë efektive në formimin e një tërësie koherente. Kjo është posaçërisht e vërtetë sa i përket synimit, me fokus në Kornizën e Kualifikimit Kombëtar, për të futurë një kulturë të vet-vlerësimit në shkollat dhe Qendrat Trajnuese të AAP-së: logjik është që kjo lëvizje duhet të ketë ndikim të thellë në tërë qasjen për përmirësimin e cilësisë në AAP në Kosovë.

Prandaj, është pranuar fakti se ekziston një nevojë urgjente për ofrimin e një pasqyrimi të komponentëve të ndryshme të sistemit ekzistues të kualifikimit, dhe

të propozohet një model i mundshëm për zhvillimin e mëtejshëm të tij sa i përket vlerësimit të jashtëm të AAP-së, në mënyrë që të lehtësohet përmirësimi në sigurimin e cilësisë të ofruar të AAP-së.

'Vlerësimi i jashtëm' përdoret këtu për tu referuar tek secili aktivitet, i jashtëm apo ofruar trajnimi të AAP-së, i cili monitoron, vlerëson, apo vlerëson ofruesin e trajnimit. Prandaj, përdoret për tu referuar jo vetëm tek aktivitetet 'inspektues', por gjithashtu si për shembull, tek të gjitha vlerësimet e jashtme të ofruesve (p.sh, akreditimi i ofruesve) apo për secilin vlerësim të të dhënave relevante (p.sh. përgatitja e raporteve për temat kyçe në AAP siç është punësimi i të diplomuarve në shkollat e AAP-së.)

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Ky udhëzues do të ofroj një pasqyrim fillestar të roleve dhe përgjegjësiave ekzistuese sa i përket vlerësimit të jashtëm të AAP-së, identifikon çështjet dhe mangësitë që dalin në pah, dhe ofrojnë një pasqyrim gjithëpërfshirës në lidhje me çka është e

nevojshme për tu bërë në mënyrë që të sigurohet se struktura ekzistuese rezulton në një sistem kualitativ i cili i përshtatet qëllimit dhe jep kontribut real në përmirësimin e cilësisë të AAP-së në Kosovë.

AUDIENCA E PIKETUAR

Audienca kryesore e paraparë për këtë publikim është Ministria e Arsimit. Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duke përfshirë departamentin e Inspektimit

dhe SIM, Këshillin për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP), dhe Autoritetin Kombëtar për Kualifikim (AKK).

2. MENAXHIMI I CILËSISË NË ARSIM DHE AFTËSIM

PASQYRË E SHKURTËR E ZHVILLIMEVE

Në 30 vitet e fundit ka qenë një tendencë nëpër Evropë (dhe gjithashtu nëpër botë) për të filluar lëvizjen nga modeli 'kontrolli shtetëror' në modelin 'mbikëqyrja shtetërore' e arsimit, pjesërisht për shkak të kalimit në vendim marrje të decentralizuar. Çdo lëvizje në drejtim të decentralizimit të përgjegjësive kërkon një rritje korresponduese me fokus në menaxhimin dhe përgjegjësinë e cilësisë. Për më shumë, zhvillimi i nevojës për këtë fokus në përgjegjësi koinçidon me një influence të rritur në arsim të modeleve të biznesit të 'sigurimit të cilësisë'.

Qysh në fillim të viteve 1990-ta menaxhimi i Cilësisë duket të jetë zhvilluar në një industri me të drejta të veta dhe roli i tij në politikën dhe ofrimin e arsimit është bërë i lartë. Së voni fokusi i tij ka lëviz me theks të veçantë në 'përmirësim të cilësisë' sesa në kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë (SC), por tendenca vazhdon në referimin e kësaj fushe të aktivitetit si 'SC'.

Prandaj është qenësore, të sqarohet ndryshimi midis 'kontrollit të cilësisë' dhe 'përmirësimit të cilësisë'

Kontrolli i cilësisë (KC)

- Është proces për mirëmbajtjen e standardeve, jo për përmirësimin e tyre
- Referohet në teknikat dhe aktivitetet e përditshme që përdoren për përmbushjen e kërkesave të cilësisë duke rregulluar performancën.

Sigurimi i cilësisë (SC)

- Kjo është tërësia e veprimeve të planifikuara dhe sistematike të nevojshme për sigurimin e konfidencës që produkti apo shërbimi do të plotësoj kërkesat e specifikuar për kualitet.
- Aktivitetet e SK-së nuk e kontrollojnë në mënyrë direkte cilësinë. Ato themelojnë kufirin në të cilin kualiteti do të /është duke u kontrolluar

Përmirësimi i cilësisë (PC)

- Përfshin të gjitha aktivitetet të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim përfitues në performancën e cilësisë. Është një proces i ndryshimit të procedurave, proceseve apo performancës përmes monitorimit, vlerësimit, analizave dhe veprimeve korrektuese.

Normalisht një sistem i cilësisë duhet të përfshij disa elemente të KK, disa nga S dhe disa nga PK.

Nevoja për të themeluar një bilanc midis masave që kontrollojnë, sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë është bërë një temë e rëndësishme e debatit në arsim dhe aftësim gjatë 20 viteve të fundit.

Ekziston një tendencë që të supozohet se lloji i aktivitetit 'kontroll i cilësisë' (për shembull, inspektime të jashtme, të jashtme) janë në thelb negative, dhe se vet vlerësimi i brendshëm vullnetar është gjithmonë pozitiv, por kjo shkakton keqkuptim të proceseve – e cila bën dallimin midis negatives dhe se monitorimi i cilësisë është mbi të gjitha synimet (a është e ndëshkueshme apo jo?) dhe rezultati (a shpie në përmirësim të cilësisë apo jo?).

Një dallim i dobishëm midis nevojës për të dëshmuar kualitet dhe për ta përmirësuar atë.

Po ashtu është e nevojshme të përmendet që 'kualiteti i matur' nuk bën asgjë për të përmirësuar cilësinë – metafora e 'weighing the pig / matjes së derrit' është e përshtatshme këtu!

Në fund, duhet pasur parasysh se zhvillimet e tanishme në përmirësimin e cilësisë fokusohen në studentë në qendër të ofruesit dhe bëjnë çdo përpjekje për të siguruar që interesat e të gjitha palëve pjesëmarrëse janë marrë parasysh. Palët pjesëmarrëse (punëdhënësit, studentët, personeli, qeveria dhe shoqëria si tërësi) mund të kenë pikëpamje të ndryshme në lidhje me cilësinë e ofruesit për ofertën.

ZHVILLIMI I KORNIZËS KOMBËTARE PËR KUALIFIKIME (KKK)

Është po ashtu e rëndësishme të bëhet dallimi midis Sigurimit të cilësisë dhe inspektimit. Edhe pse inspektimi është një aspekt i sistemit të menaxhimit të cilësisë, ekipet e inspektimit zakonisht kanë përgjegjësi shumë specifike zakonisht të përcaktuara me ligj të cilat nuk mund të kryhen nga palët tjera. Para së gjithash ata janë përgjegjës për informimin e Qeverisë në lidhje me:

- Cilësinë e ofruesit
- Standardet e arritura
- A ka pas përdorim eficient të financave

Në mënyrë që të bëhen këto vlerësime, inspektorati merr parasysh një varg informacionesh dhe të dhënash, duke përfshirë vet-vlerësimin e shkollave,

e cila validohet nga ana e inspektoratit (apo jo) si rezultat i evidencës së dorës së parë të fituar gjatë inspektimit.

Nga ana tjetër sistemi i sigurimit të cilësisë:

- Vlerëson efikasitetin e ofruesve në vazhdimësi duke përdorur një varg burimesh, përfshirë rezultatet e inspektimit.
- Operon një cikël vjetor të menaxhimit të cilësisë si bazë për vendime në lidhje me mirëmbajtjen/përmirësimin e performancës së ofruesve.

Ky dallim mund të jetë i dobishëm në kontekstin e vlerësimit të jashtëm të AAP-së në Kosovë kur lind nevoja për sqarimin e roleve dhe përgjegjësi të palëve të ndryshme.

3. SISTEMI EKZISTUES I CILËSISË PËR AAP NË KOSOVË

Paragrafët e mëposhtëm ofrojnë një pasqyrim preliminar të Sistemit të Cilësisë për AAP-në siç ekziston momentalisht.

KOMPONENTËT E SISTEMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

Kosova posedon, apo është duke zhvilluar momentalisht shumë aspekte të sistemit të cilësisë.

1. Rregullimi i përbashkët: MASHT-i aprovon programet dhe licencon institucionet të cilat kontribuojnë në koncepte, kurrilla dhe standarde profesionale kombëtare.
2. Vlerësimi i jashtëm i shkollave të AAP_së përmes inspektimeve administrative dhe profesionale nga ana e departamentit të inspektimit të MASHT-it.
3. Sigurimi i cilësisë të Qendrave Aftësues Profesionale të MPMS-së dhe qendrave mobile nga ana e divizionit profesional të MPMS-së.
4. Vlerësimi i brendshëm i shkollave përmes përvojës së paraqitur së voni të vet-vlerësimit.
5. Testet dhe provimet e jashtme posaçërisht Matura dhe testet e standardizuara pas klasës së 9-të.
6. Roli i sigurimit të cilësisë të zyrës për Standarde dhe Vlerësim në MPMS.
7. Aprovimi i AAP-së për kualifikime dhe akreditime të institucioneve të cilat zhvillojnë, vlerësojnë dhe japin kualifikime.
8. Zhvillimi i Kornizës Kombëtare për Kualifikim (KKK).

9. Grumbullimi i të dhënave statistikore nga njësia Informative e Menaxhimit të Arsimit (SMIA).

10. Roli i komunave sipas ligjit për 'mbikëqyrje dhe inspektim të procesit të arsimit sipas udhëzimeve të themeluara nga MASHT-i,' dhe në fushat tjera të cilat ndikojnë në cilësinë e ofruesit të AAP-së.

11. Përfshirja e palëve pjesëmarrëse përmes KAAP-së Prandaj, komponentët ekzistuese nuk janë të 'sistematizuara' dhe ekziston tendenca për të zhvilluar fusha diskrete pa kujdes të mjaftueshëm për ndikim në fushat tjera.

Më e rëndësishme, ndoshta duket të jetë gabim sistematik për tu adaptuar me filozofinë apo shpirtin e qasjeve moderne të menaxhimit dhe përmirësimit të cilësisë.

Kjo do të bëhet veçanërisht e evidente kur të bëhet përdorimi i vet-vlerësimit në praktikën e ofruesve të arsimit dhe aftësimit, vetëm nëse reflektohet në ndryshimet e qasjes së inspektoratit, apo palëve siç janë (SMIA) në MASHT.

SITUATA NË KOSOVË NË LIDHJE ME SIGURIMIT TË CILËSISË TË JASHTËM TË AAP-SË

Institucionet kyçe me përgjegjësi, në një aspekt apo në ndonjë tjetër për sigurimin e cilësisë të jashtëm të AAP-së janë si në vijim:

MASHT:

MASHT momentalisht ka përgjegjësi direkte për cilësinë e AAP-së në shkollat e AAP-së, përfshirë shkollat të cilat ofrojnë aftësi si në sektorin bujqësor, i cili në vendet tjera do të ishte mbështetur nga Ministria e Bujqësisë. MASHT-i është përgjegjës për licencimin dhe rregullimin e shkollave, dhe inspektorati është Departamenti i MASHT-it.

Divizionet tjera të MASHT-it kanë përgjegjësi direkte për sigurimin e cilësisë: për shembull Zyra e Standardeve dhe Vlerësimit në MASHT e cila merret me vlerësimin e cilësisë të Maturës, dhe Njësia Informative e Menaxhimit të Arsimit ka përgjegjësi për grumbullimin dhe përpilimin e informacioneve statistikore

MPMS:

Roli i **MPMS-së** në sigurimin e cilësisë të AAP-së është të mbështes dhe monitoroj punën e Qendrave për Aftësim Profesional (QAP) të cilat janë themeluar nga Ministria. Një zyrtar nga Divizioni Profesional ka përgjegjësi për zhvillimin e vizitave monitoruese në QAP. Prandaj nuk përcillet një grup modeli, dhe përfshin 'kontroll në vend'. Vizitat monitoruese përfshijnë aktivitetet për verifikim të certifikatave, modelimin e dosjeve, kontrollimi i bazës së të dhënave të QAP-it dhe intervistimi i kandidatëve. Drejtorët e QAP-it po ashtu marrin pjesë në takimet mujore në MPMS.

KOMUNAT:

Roli i Komunave sa i përket sigurimit të cilësisë është zgjeruar dukshëm, pas aprovimit të ligjit mbi Arsimin në Komunitet e Kosovës në vitin 2008. Komunitet kanë përgjegjësi për çështjet e cilësisë siç janë 'monitorimi dhe raportimi për studentët' përparimi arsimor dhe shoqëror i prindërve dhe autoriteteve përgjegjëse siç është e përcaktuar me ligj dhe 'monitorimi dhe raportimi i menaxhimit të arsimit dhe operimet në komuna', dhe 'mbikëqyrja dhe inspektimi i procesit të arsimit sipas udhëzimeve të themeluara nga MASHT-i,' si dhe kompetencat sa i përket fushave përcjellëse siç janë 'regjistrimi dhe licencimi i institucioneve arsimore, rekrutimi, pagesa e pagave dhe aftësimeve të instruktorëve dhe administratorëve arsimor.'

KAAP:

KAAP ka një rol të rëndësishëm, të ruajtur me Ligjin e AAP-së, për të 'këshilluar Qeverinë në çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë dhe ofrimin e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë'. Prandaj Ligji i AAP-së po ashtu cek se KAAP ka përgjegjësi direkte dhe indirekte për cilësinë e AAP-së në Kosovë në aspekt të gjerë të fushave (për detaje, shih Shtojcën 1) Mbase me e rëndësishme në aspektin e përgjegjësisë indirekte, KAAP thjeshtë nuk është në gjendje të kryej funksionet sipas ligjit nëse nuk ka një pasqyrim të cilësisë. Është e qartë pra se KAAP ka një rol kyç për të luajtur në vlerësimin e jashtëm të ofrimit të AAP-së në Kosovë, jo në mënyrë direkte siç ishte rasti me inspektoratin apo AKK, për shembull por në mënyrë indirekte për nevojat e të qenit të informuar mirë mbi situatën në AAP, të jenë në gjendje të kërkojnë raporte dhe të dhëna të përshtatshme, ti analizojnë ato dhe të bëjnë rekomandime të duhura për MASHT-in apo për Qeverinë e Kosovës.

Si shtesë, KAAP si palë udhëheqëse trepalëshe e përfshirë në AAP në, është në pozitë të veçantë pasi qe ka potencial të 'shtoj vlera' në Sistemin e Cilësisë duke ofruar të dhëna nga Ministrinë tjera dhe partnerët social, dhe të kontribuoj në mënyrë direkte për të përmirësuar cilësinë e AAP-së duke rritur pjesëmarrjen e partnerëve social.

Në fund, duhet mbajtur mend se AAP nuk është thjeshtë vetëm AAP formal i cili zhvillohet nëpër shkolla. KAAP është autoritet i vendosur në mënyrë ideale për të pasur informacione të nevojshme për cilësinë e AAP jo formale gjithashtu.

AKK:

AKK ka përgjegjësi për themelimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare për Kualifikim, e cila i jep AKK rol të rëndësishëm në cilin do sistem të sigurimit të cilësisë në tërësi për AAP-në.

Për me shumë, AKK-ja bashkërisht me MASHT-in dhe AKA, është përgjegjës për rregullimin e kualifikimeve dhe për akreditimin e arsimit dhe institucioneve për të vlerësuar dhe lëshuar kualifikime. Po ashtu, AKK është në mënyrë potenciale përgjegjëse për akreditimin e ofruesve qe ofrojnë aftësi si dhe për të vlerësuar dhe shpërblyer. AKK-ja luan po ashtu rol të rëndësishëm sa i përket sigurimit të cilësisë të AAP-së në Kosovë.

AKA:

Në kontekstin e sistemit të AAP, Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) është përgjegjëse për akreditimin kolegjeve post-sekondare profesionale përveç rolit të tij kryesor në akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë.

4. ÇËSHJTJET DHE MANGËSITË

ÇËSHJTJET NË SIGURIMIN E CILËSISË SË JASHTME NË KOSOVË

Edhe pasqyrimi i shkurtër i dhënë më lartë i roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve të ndryshme të cilat në njëfarë mënyre marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm të AAP-së në Kosovë, e theksojnë nevojën për një pasqyrim më të qartë të situatës, dhe çështjeve të shtruar siç janë për shembull,

1. Si ndikojnë përgjegjësitë e reja të Komunave për aspektet e ndikimit të sigurimit të cilësisë në transferimet ekzistuese të institucioneve tjera?
2. Si mund të implementohet roli i KAAP-së në SC.?
3. Cili është raporti midis Departamentit të Inspektorëve të MASHT-it dhe AKK-së sa i përket përgjegjësisë për vlerësimin e vet-vlerësimeve të brendshme të kryera nga shkollat e AAP-së?
4. Cili është raporti midis procesit të licencimit të MASHT-it dhe procesit të themeluar nga AKK-ja për të akredituar ofruesit e aftësimi?

Megjithatë, ekzistojnë dhe disa çështje të rëndësishme që duhen marrë parasysh të cilat nuk dalin në shesh detyrimisht nga pasqyrimi i dhënë më lartë. Këto përfshijnë:

1. Si mund të zhvillohet sistemi i inspektimit për të lejuar futjen e vet-vlerësimit nëpër shkolla?
2. Si mund të përmirësohet kualiteti dhe përdorimi i të dhënave dhe statistikave?
3. Kush është përgjegjës për analizimin e të dhënave në mënyrë që të identifikohen çështjet për përmirësim?
4. Si janë pikëpamjet e partnerëve social të përfaqësuar në sistemin e cilësisë të AAP-së?
5. Si janë pikëpamjet e nxënësve dhe palëve tjera pjesëmarrëse të përfaqësuara?

Ky dokument bën përpjekjet e para për të hulumtuar këto çështje dhe propozuar se çka duhet bërë nga organizata kryesore e përfshirë në mënyrë që të përmirësohet sigurimi i cilësisë të AOO-së përmes vlerësimit të jashtëm.

MANGËSITË NË SIGURIMIN E CILËSISË SË JASHTME NË KOSOVË

Mangësia më e dukshme në termat praktik është mungesa e ndonjë autoriteti përgjegjës për verifikimin e jashtëm të kualifikimeve, apo verifikimin e jashtëm vlerësimit në ndonjë pikë. Është vështirë të shihet se si AKK mund të sigurojë transparencën dhe konkurentshmërinë e kualifikimeve Kosovare të AAP për tregun ndërkombëtar, derisa ky element të vendoset.

Mangësi tjetër e madhe duket të jetë sa i përket SMI: edhe pse ekziston Departamenti për Statistika Arsimore, dhe Departamenti i Inspektorëve, duket të ketë zhvillime të pakta të përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave (SMI) për krijimin e raporteve dhe analizave. Për më shumë, duket se nuk ka përpjekje sistematike për grumbullimin e të

dhënave të cilat rekomandohen nga EQAF Korniza Referuese si bazë për indikatorët për të vlerësuar cilësinë në AAP.

Mbi të gjitha, edhe pse shumë elemente të sigurimit të cilësisë të jashtme janë në vend, nuk është planifikuar sistem koherent kualitativ.

5. PROPOZIMET PËR HAPAT NE TË ARDHMEN

Në vijim janë propozuar hapat e nevojshëm që duhen marrë nga institucionet kyçe në mënyrë që të sigurohet një koherencë me e madhe sa i përket vlerësimit të jashtëm, dhe të ndërtoj një proces për sigurim të cilësisë i cili fokusohet më shumë në përmirësimin e cilësisë sesa thjeshtë të 'kontrolloj'.

MASHT:

Në mënyrë që të sigurohet sistemi i sigurimit të cilësisë për AAP i përmbush vlerat e tanishme, është e rëndësishme që MASHT-i të zhvilloj një qasje e cila thekson një fokus pozitiv të përmirësimit të cilësisë. Posaçërisht, do të jetë e dëshirueshme për MASHT-in që të:

- Siguroj, në bashkëpunim me KAAP që sistematizimi i të gjitha elementeve të vlerësimit të jashtëm të zhvillohet në mënyrë që të krijohet një sistem kualiteti gjithëpërfshirës dhe koherent për ofrimin e AAP-së në Kosovë. Është qenësore të sqarohen raportet ndërmjet përgjegjësive kombëtare dhe komunale për sigurimin e cilësisë të AAP-së. Është gjithashtu qenësore që procesi të sqaroj raportin ndërmjet Departamentit të Inspektoratit në kuadër të MASHT dhe AKK për sa i përket përgjegjësive për validimin e vetëvlerësimeve të realizuara nga shkollat e AAP, gjithashtu edhe marrëdhënien ndërmjet procesit të licencimit të MASHT dhe procesit të themeluar nga AKK për akreditimin e institucioneve të AAP.

- Siguroj, që në bashkëpunim me KAAP që në Sistemin e Cilësisë të përfshihen mekanizmat në të cilët janë të reflektuar pikëpamjet e nxënësve, partnerëve social dhe palëve tjera me interes.
- Mbështes zhvillimet aktuale në vet-vlerësimin e shkollave, mundësisht në instancën a parë duke ndryshuar Ligjin për të bërë vet-vlerësimin të detyrueshëm përdërisa të futet në kulturën e të gjithë ofruesve.
- Reformoj sistemin e inspektimit për tu bërë në pajtim me theksin e vet-vlerësimit të shkollave, dhe për ta lëvizur filozofinë e inspektimit nga një kontroll kualiteti në një përmirësim cilësisë (po ashtu shih më poshtë seksionin brenda Departamentit për inspektim). Në këtë aspekt ka gjasa që ndryshimet në ligjin për inspektim do të jenë të nevojshme pasi që ligji aktual merret me sistemin i cili edhe pse është teknikisht në pajtim me EFAQ, mund të argumentohet si jo më 'i përshtatshëm për këtë synim' pasi që nuk i merr parasysh ndryshimet e rëndësishme në Menaxhimin Cilësisë në arsim gjatë 30 viteve të fundit.
- Zhvilloj një sistem të brendshëm të menaxhimit të cilësisë në divizionin e AAP-së për të siguruar që komponentët e nevojshme janë në vend, dhe të implementuara. Një person i dominuar duhet të ketë përgjegjësi për sigurimin që kjo do të ndodh, të paktën në afat të shkurtës, derisa SK të bëhet një pjesë e integruar e aktivitetit.

- Ofroj mbështetje për zhvillimin e mëtutjeshëm të EMIS si një komponent të rëndësishë së lartë të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në veçanti, konsideratë të mëtutjeshme duhet ti jepet se si do të analizohen të dhënat në dispozicion për të krijuar raporte të cilat ndihmojnë zhvillimin e përmirësimit të cilësisë, dhe çfarë të dhënash shtesë mund të grumbullohen në mënyrë që të ofrohen informacione themelore të menaxhmentit për krijimin e politikës.
- Siguroj se sistemi është themeluar për të filluar grumbullimin të dhënave të rekomanduara nga Korniza referuese e EQAF-it si një bazë e indikatorëve për të vlerësuar cilësinë në AAP

Departamenti i MASHT-it për Inspektim

Nuk është brenda fushë veprimit të këtij dokumenti që të vë në pah ndonjë hollësi të punëve të sistemit të inspektimit të cilat mund të shërbejnë si alternative të mundshme të atyre që janë aktualisht në operim në Kosovë.

Prandaj, është e mundshme të ceken fushat të cilat Departamenti për Inspektim duhet ti ketë parasysh nëse aktivitetit i tyre lidhet me një fokus të ri të vet-vlerësimit të shkollave, dhe nëse sistemi duhet modernizuar për të marrë parasysh zhvillimet diku tjetër.

Vet-vlerësimi është qendror për vlerësimet në lidhje me udhëheqësin dhe menaxhmentin, dhe për kapacitetin e shkollave për tu përmirësuar.

Edhe pa reformë komplete të sistemit të inspektimit, duhet të jetë e mundshme të paraqes ndryshimet të cilat do ta bëjnë sistemin më shumë me marrëveshje me qasjet aktuale. Në veçanti, do të jetë e nevojshme të:

- **Rishikoj synimet e inspektimit**, vendosja e nevojave të nxënësit në qendër, dhe fokusimi në rolin e inspektimit në përmirësimin e cilësisë të ofruesit.
- Një nga synimet e veçanta të inspektimit duhet të inkurajojnë kulturën e vet-vlerësimit në institucionet e inspektuara (për të dhënat se si të përmirësohet kualiteti i inspektimit, shih Shtojcën 2
- **Rishikoj principet e inspektimit**, prapë duke marrë parasysh nevojën e fokusimit në përmirësim të cilësisë, por gjithashtu duke marrë parasysh politikat për barazi dhe diversitet, dhe interesat e palëve pjesëmarrëse siç janë të rinjtë, prindërit, të rriturit dhe punëdhënësit. Principet normalisht do të ri afirmojnë centralizimin e vet-vlerësimit të shkollave në procesin e inspektimit.
- **Rishikoj Kodin e Sjelljes së Inspektorëve**, duke pasur parasysh se synimi i inspektimit nuk është kontrolli i cilësisë, por derisa të jetë e mundshme të bëhet një përpjekje e përbashkët duke përfshirë inspektorët dhe institucionet që inspektohen që të bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë të ofrimit.
- **Shqyrtoj se çfarë informacionesh duhet të përdor Inspektori para inspektimit** zhvillohet në mënyrë që të përdoret sa më mirë koha me ofruesin, dhe të sigurohet që inspektimi kontribuon në përmirësimin e ofruesit. Kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme në kontekstin në të cilin shkollat kanë zhvilluar përvojën e tyre në vet-vlerësim – analizat e ofruesit dhe vlerësimi i performancës vetanake duhet të luajnë rol të fuqishëm kur finalizohen çështjet për inspektim dhe planet për shpërndarjen e ekipit inspektues.

- Dokumentimi i para-inspektimit duhet të përfshij jo vetëm dokumentet të cilat i instruktori i kërkon ofruesit të ketë në dispozicion, por gjithashtu edhe:
 - Raportin me të vonshëm të vet-vlerësimit të ofruesit.
 - Dokumentet të cilat shkolla dëshiron që inspektori ti marrë parasysh.
 - Reagimet nga ana e nxënësve.
 - Reagimet nga ana e punëdhënësve.
- Merr parasysh filozofinë përpjekjeve të përbashkëta për përmirësim të cilësisë, departamenti për inspektim duhet po ashtu të **hulumtoj praktikën e përpilimit të udhëzimeve të para-inspektimit** e cila rrjedh nga analizat e dokumentimit të para-inspektimit, dhe i cili specifikon fushat në të cilat inspektimi ka gjasa të fokusohet (dhe cilat fusha nuk kanë nevojë për inspektim). Udhëzimet e para-inspektimit duhet ti dërgohen paraprakisht institucionit që duhet inspektuar.
 - **Zhvilloj metodologji për të siguruar përdorim efikas të raportit të vet-vlerësimit dhe planifikimin e zhvillimit të ofruesit.** Inspektorët mund të përdorin raportin për të vlerësuar rrezikun, monitorojnë standardet dhe planifikojnë për inspektim. Kur temat e lëmive duhen inspektuar, raporti mund të ndihmojë inspektorin udhëheqës në përzgjedhjen e fushave për inspektim. Gjatë inspektimit, konkluzionet do të krahasohen me ato të raportit të vet-vlerësimit të ofruesit, dhe konkluzioni i arritur për saktësinë e këtyre vlerësimeve.
 - Kualiteti i planifikimit zhvillimor të ofruesit mund të përdoret po ashtu për të ofruar treguesit e kapacitetit për përmirësim të ofruesit, si dhe si evidencë për vlerësimin në lidhje me cilësinë e menaxhimit dhe udhëheqësisë.
- **Themeloj procedura për zbulimin e pikëpamjeve të nxënësve, punëdhënësve dhe palëve tjera pjesëmarrëse** në lidhje me punon e ofruesit para dhe gjatë inspektimit.
 - **Rishikoj qasjet për mbledhjen dhe përdorimin e evidencës** për të marrë parasysh përparësitë e përdorimit të rangut me të gjerë të metodave. Këto mund të përfshijnë jo vetëm mbikëqyrjen e mësimit por gjithashtu edhe diskutimet me nxënësit dhe analizat e punës së tyre; analizat e të dhënave të ofruesve, dokumentet dhe pyetësorët e nxënësve dhe punëdhënësve; dhe takimet me nxënësit, punëdhënësit, personelin, guvernatorët dhe partnerët e ofruesit kur është e nevojshme.
 - **Përmirësoj cilësinë e mbikëqyrjes së mësimdhënës, trajnimit dhe vlerësimit i cili ka potencial të informoj** vlerësimet e inspektorëve në lidhje me rezultatet e nxënësve, efektivitetin e ofruesit, udhëheqësinë dhe menaxhmentin dhe kapacitetin për përmirësim të ofruesit.
 - **Përmirësoj përdorimin e të dhënave të inspektoratit** duke zgjeruar llojin e të dhënave të mbledhura (për të përfshirë për shembull llojin e të dhënave të rekomanduara nga Korniza referuese e EQAF-it) dhe të përmirësoj analizat e të dhënave ekzistuese.
 - Implementoj një sistem për të përmirësuar **sigurimin e cilësisë së inspektimeve.**

KAAP

Në mënyrë që të jemi në gjendje të përmbushim funksionet e tij sipas Ligjit mbi AAP-në, është qenësore që KAAP të bëhet më pro aktive sa i përket vlerësimit të jashtëm të AAP-së në Kosovë. Posaçërisht, do të jetë e nevojshme për KAAP-në që të:

- Krijoj një **pasqyrë** të Menaxhimit të Cilësisë të AAP-së në Kosovë. Kjo pasqyrë do të bashkoj raportet nga të gjitha palët tjera me përgjegjësi për secilin aspekt të vlerësimit të jashtëm të AAP-së. Materiali do të sintetizohet dhe analizohet në pikëpamje të theksimit të çështjeve kryesore, dhe krijimi i rekomandimeve të duhura për MASHT-in dhe Qeverinë në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit mbi AAP-në i cili citon se 'KAAP duhet të këshilloj MASHT-in dhe Qeverinë e Kosovës për drejtimet e përgjithshme të politikës për arsim dhe aftësim profesional në Kosovë.'
- KAAP-ja do të shfrytëzoj pozitën e saj unike si autoritet tregalësh duke siguruar një perspektivë me te gjere për analiza, në mënyrë që të kontribuoj në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë e AAP-së duke rritur pjesëmarrjen e komunave, partnerëve social dhe palëve tjera pjesëmarrëse.
- Propozoj një **sistematizim të vlerësimit të jashtëm** të AAP-së për të siguruar përfshirjen e të gjitha aspekteve të nevojshme të sistemit të menaxhimit të cilësisë kombëtar duke marrë parasysh përgjegjësitë e komunave.
- Themeloj një mekanizëm për të siguruar se KAAP-ja përdor kushtetutën tregalëshe në mënyrë që tu mundësoj të gjitha palëve pjesëmarrëse të 'shtojnë vlera' në sistemin e menaxhimit të cilësisë kombëtar.

- Themeloj një sistem për menaxhim të cilësisë të KAAP-së i cili do të përfshinte elementet në vijim:
- Një cikël planifikimi i cili përfshin rolin e sigurimit të cilësisë të KAAP-së
- Një listë kontrolluese të raporteve të nevojshme në bazë vjetore nga KAAP-ja
- Një proces për identifikimin e temave që kërkojnë raporte shtesë
- Një plan të procesit që duhet përdorur për analizimin e raporteve, identifikimit të çështjeve të shtruara, hulumtime të mëtutjeshme të komisionit nëse është e nevojshme, dhe të bëhen rekomandimet për Qeverinë
- Një plan i procesit për tu përdorur për të siguruar se KAAP është në gjendje të marr të gjitha përgjegjësitë specifike për vlerësim të jashtëm/sigurim të cilësisë të cilat janë të specifikuar në ligjin mbi AAP-në.
- Një mekanizëm i cili siguron se sigurimi i cilësisë në KAAP nuk shihet si përgjegjësi e nën komitetit të SK-së, por si diçka e cila është përbërëse e punës së të gjitha komiteteve
- Një mekanizëm i cili garanton se të dhënat nga anëtarësia tri paleshe e KAAP është e futur në mënyrë strukturale në ciklin e brendshëm të MK të KAAP-së.
- Themeloj mekanizëm të përshtatshëm për të siguruar se KAAP-ja është në gjendje të supozoj të gjitha përgjegjësitë specifike për vlerësimin e jashtëm/sigurimin e cilësisë të cilat janë të specifikuar në Ligjin mbi AAP-në (shih Shtojcën 1)

- Themelohet procedura për të rregulluar se si duhet të sillen KAAP me të drejtat e saj për të kërkuar një vlerësim të sistemit të arsimit profesional formal sipas Nenit 29.1 të Ligjit për AAP.
- Pas konsultimit me të gjitha palët relevante pjesëmarrëse **propozohen ndryshimet në ligjin e AAP-së** për të fshirë çdo përgjegjësi për vlerësim të jashtëm i cili nuk është i përshtatshëm për tu pranuar si i drejtë për KAAP-në.

AKK:

AKK-ja është në proces të zhvillimit të shumë procedurave dhe mjeteve të cilat do të formojnë pjesën e një sistemi të përgjithshëm të cilësisë.

Prandaj është e domosdoshme që AKK-ja të:

- **Bashkëveproj me MASHT-in, KAAP-në dhe komunat** në mënyrë që të nxis sinergji dhe të mënjanoj sa më shumë që është e mundur ndonjë përsëritje të aktiviteteve të sigurimit të cilësisë, veçanërisht kërkesat e dyfishuara për informacione nga shkollat, të cilat nuk janë në përputhje me një sistem kualiteti efektiv.

- Në veçanti, në kontakt me MASHT të sqaroj dhe pajtohet për raportet ndërmjet Departamentit të Inspektoratit në kuadër të MASHT dhe AKK për sa i përket përgjegjësi për validimin e vetëvlerësimeve të realizuara nga shkollat e AAP, gjithashtu edhe marrëdhënien ndërmjet procesit të licencimit të MASHT dhe procesit të themeluar nga AKK për akreditimin e institucioneve të AAP.
- Zhvilloj, si çështje urgjente, një mekanizëm i thjeshtë **për sigurimin e verifikimin e jashtëm të vlerësimit të arritjeve të studentit** i cili është aspekt kyç për secilin sistem të sigurimit të cilësisë për AAP.

6. PROPOZIMET PËR BASHKËPUNIM NË TË ARDHËM

Propozimet e hollësishme për bashkëpunim në të ardhmen do të ndjekin nga auditimi gjithëpërfshirës i cili është i propozuar do të bëhet nga KAAP-ja, dhe i cili do të ofroj një pasqyrim të komponentëve ekzistuese të vlerësimit të jashtëm të AAP-së në Kosovë, dhe të ndriçoj ndonjë përputhje ndonjë apo mangësi. Nëse për ndonjë arsye KAAP nuk është në gjendje të udhëheqë një auditim të tillë, i rekomandohet fuqishëm MASHT që të ndërmerr udhëheqjen e nevojshme, ose të delegoj përgjegjësinë për auditim të një trupë tjetër.

Prandaj, në këtë pikë është e rëndësishme që të gjitha institucionet e përfshira të jenë të vetëdijshme se rolin që ato luajnë në vlerësimin e jashtëm është thjeshtë një element i një fotografie me të madhe. Figura 1 më poshtë përpiqet të paraqes atë pikëpamje në formë grafike. Figura 2 sugjeron bashkëpunimin e njëjtë në të ardhmen kur Sistemi i Cilësisë është më koherent. Prandaj, rekomandohet që të përpiqeni të shpërndani udhëzuesin së bashku me diagramet.

7. KONKLUZIONE

Edhe pse ky pasqyrim i shkurtër shtron shumë pyetje dhe thekson nevoja urgjente për zhvillimin e qasjes së sistematizuar dhe koherente për vlerësimin e jashtëm të AAP-së në Kosovë. Ekzistojnë shumë përsëritje potenciale të përgjegjësive, një situatë e cila nuk është e përshtatshme me një sistem efektiv të cilësisë. Për më shumë, edhe pse nuk duket të ketë shumë mangësi, por disa që janë identifikuar

janë shumë të rëndësishme. Prandaj, sistemi aktual nuk i jep vend të përshtatshëm theksit në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve për vet-vlerësimin e ofruesve, apo rekomandimeve të Kornizës Referuese të EQAF-it sa i përket treguesve të cilësisë. Mbi të gjitha, ekziston një gabim aktual për implementimin e rolit të rëndësishëm në SK të caktuar në KAAP sipas ligjit për AAP.




FIGURA 1




FIGURA 2

ANEKSET

ANEKSI 1: ANALIZA A LIGJIT TË AAP ME REFERENCË NË ROLIN E KAAP NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E JASHTËM/SIGURIMI I CILËSISË NË AAP

Ligji i AAP e bën vetëm një referencë për rolin e KAAP për sa i përket cilësisë së AAP në Kosovë: Neni 13.1 thotë “Në bashkëpunim me Institucionet e tjera të Qeverisë së Kosovës dhe Partnerët Social, MASHT do të themelojë Këshillin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (më tutje në tekst KAAP) në mënyrë që të **drejtojë kursin e zhvillimit dhe të këshillojë MASHT-in në çështjet lidhur me cilësinë** dhe promovimin e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë”

- Prandaj, KAAP ka nevojë statutare që të ketë rol në vlerësimin e jashtëm të AAP.
- Megjithatë, një analizë e Ligjit të AAP tregon se KAAP ka përgjegjësi direkte dhe indirekte për cilësinë e AAP në Kosovë në shumë fusha.
- Për sa i përket përgjegjësisë direkte operacionale, janë disa fusha të përmendura në ligjin e AAP, p.sh.:
- Neni 27.6 i ligjit thotë “MASHT-i, nxjerr Udhëzim Administrativ për kalimin e provimit të fundit dhe përbërjen e komisionit provues, i cili do të varet së pari nga propozimi KAAP. Pjesa praktike e provimit të fundit për nxënësit në ekonomi dhe provimi në zejтари (profesion)”.
- Neni 27.9. “Forma e organizimit dhe kërkesat e provimit, do të rregullohen nga MASHT me Udhëzim Administrativ me mendimin paraprak të KAAP”.
- Neni 23 Programet e arsimit pedagogjik - andragogjik për drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe personelin mësimdhënës në institucionet që ofrojnë programe të arsimit dhe aftësimin profesional formal, do ti bie MASHT duke marrë parasysh këshillat nga KAAP.

- Ndoshta shumë më e rëndësishme, për sa i përket përgjegjësisë indirekte, KAAP thjeshtë nuk është në gjendje të kryejë funksionet e tij që parashihen me ligjin mbi AAP nëse nuk e ka si pikëvështrim cilësinë.
- Për shembull, sipas ligjit të AAP.
- Neni 15.2. thotë “KAAP do të rishikojë çështjet e zhvillimit të arsimit dhe aftësimin profesional, do japë këshilla, propozime dhe rekomandime të MASHT-it, përfshirë propozimet për ligjet dhe dokumentet tjera zyrtare, lidhur me arsimin profesional. Gjithashtu, do të sigurojë një forum gjithëpërfshirës për harmonizimin e politikave dhe qasjeve përgjatë tërë sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional, nëpërmjet angazhimit të partnerëve shoqëror dhe bartësve të tjerë me interes”.
- Neni 15.1. thotë KAAP këshillon MASHT-in dhe Qeverinë e Kosovës në orientimin e përgjithshëm për politikën e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë.
- Neni 29.1. thotë “Evaluimi i sistemit të arsimit profesional mund të bëhet me kërkesën e:
 - Qeverisë ose MASHT;
 - KAAP;
 - Me kërkesë të përbashkët e së paku dy partnerëve social”.

Prandaj, është e qartë që KAAP ka rol shumë të rëndësishëm në sistemin e cilësisë për vlerësimin e jashtëm të sistemit të AAP në Kosovë dhe pamundësia ekzistuese që ka KAAP për ta luajtur rolin e tij, lën zbrazëti të madhe në sistem.

ANEKSI 2: SI MUNDET QË INSPEKSIONI TË PROMOVOJ PËRMIRËSIMET?

1. Inspektimi i ofruesve promovon përmirësimin me:

- Vendosjen e parashikimeve; kritereve dhe karakteristikave brenda kornizës së inspektimit, këshillimit e pasqyron cilësinë dhe efektivitetin e ofertës së parashikuar nga ofruesve.
- Rritjen e besueshmërisë së ofruesit duke vërtetuar pikëpamjen e tij për efektivitetin e tij atëherë kur kjo është e saktë dhe duke ofruar sfida profesionale atëherë kur është i nevojshëm përmirësimi.
- Rekomandimin e prioriteteve për veprime të ardhshme nga ofruesi, me rastin e rekomandimit të prioriteteve për veprime dhe kur është e përshtatshme kontrollimin e progresit përkatës,.

- Fuqizimin e dialogut konstruktiv ndërmjet inspektorëve, udhëheqësve dhe stafit të ofruesve.
- Kompletimin e vetëvlerësimit të ofruesit dhe promovimin e tij, në mënyrë që të rritet kapaciteti i ofruesit për ta përmirësuar ofertën e tij.
- Identifikimin e praktikës më të mirë, edhe sa i përket inspektimit dhe raporteve të hulumtimit, të cilët mund të ndahen me sektorin.

(pjesë e nxjerrë nga Ofsted Handbook për inspektimin e arsimit të vazhdueshëm dhe shkathtësive, Shtator 2009)

Për më shumë informata, ju lutem na kontaktoni:

Adresa: Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n.
Prishtinë, 10000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 212 595

Fax: +381 (0) 38 213 433

Web: www.akk-ks.net



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian



Implementuar nga: